

Certifikata Shqiptare e Psikoterapisë

Përkufizimi i CSHP

Certifikata Shqiptare e Psikoterapisë (CSHP) është një certifikatë që njeh kualifikimin profesional në psikoterapi, në Shqipëri. Ajo është permanente/për gjithë jetën. Personi që aplikon për këtë certifikatë duhet të regjistrohet si anëtar i Shoqatës Shqiptare për Psikoterapi (SHSHP) dhe njeh Kodin Etik sipas Shoqatës Europiane të Psikoterapisë (EAP) (www.europsyche.org).

Procedura e Certifikimit

CSHP mund të lëshohet përmes dy procedurave:

1. *Procedurë e drejtpërdrejtë e certifikimit*

- a. Personi duhet të ketë kryer 3 vjet studimesh në shkencë sociale ose mjekësore, ose eksperiencë arsimore e profesionale ekuivalente dhe ka përfunduar trajnimin në psikoterapi. Ky trajnim duhet të përfshijë të gjithë elementët e mëposhtëm, në një total prej 1400 orësh dhe të shtrira në një minimum prej 4 vjetësh:
 - i. vetë-eksperiencë/terapi personale në një minimum prej 250 orësh,
 - ii. teori dhe metodologji të një modaliteti psikoterapie të bazuar shkencërisht, nga 500-800 orë,
 - iii. punë klinike me klientë, nën supervizion profesional në një minimum prej 300 orësh, dhe
 - iv. supervizion profesional personal në një minimum prej 150 orësh.
- b. Personi duhet të ketë kryer një minimum prej 5 vjetësh studime të psikoterapisë (të cilat përfshijnë trajnimin), të organizuara nga universitete dhe që përfshijnë të katërt elementët e sipërpërmendur, në të paktën të njëjtën sasi orësh.

2. *Procedurë speciale e certifikimit ('Grandparenting')*

Procesi i njohjes së praktikuesve, trajnimi i të cilëve në psikoterapi nuk i plotëson të gjitha kriteret për përfitim të CSHP, por të cilët kanë fituar ekspertizë përmes praktikës së gjerë dhe trajnimit të konsiderueshëm në psikoterapi, njihet si 'procedurë speciale e certifikimit'. Ajo bazohet në parimet e mëposhtme:

- a. Ruhen standardet e larta të CSHP
- b. Praktikuesi ka nivel shprehish të njëjtë ose më të lartë në psikoterapi, të formuara përmes të katër elementëve të lartpërmendur të trajnimit në psikoterapi (teori, terapi personale, praktikë klinike dhe supervizim profesional), krahasuar me atë të një praktikuesi të trajnuar me standardet e CSHP
- c. Praktikuesi ka ekspertizë në një modalitet të psikoterapisë, i cili njihet nga EAP.
- d. Praktikuesi ka punuar në praktikë profesionale të pavarur për një periudhë kohe të përshtatshme për të justifikuar 'procedurën speciale'. Kohëzgjatja e përshtatshme e kësaj praktikë vlerësohet në çdo aplikim individual dhe zakonisht nuk duhet të jetë më pak se 10 vjet. Përjashtimet janë të mundura.
- e. Praktikuesit të cilët janë në trajnim, apo e kanë përfunduar së fundmi, nuk do të konsiderohen për procedurë speciale, por trajnimi i tyre mund t'iu njihet në retrospektivë, përmes procedurës së drejtpërdrejtë të CSHP.

3. CSHP honorifike

SHHP mund të lëshojë CSHP honorifike për profesionistët të cilët kanë dhënë një kontribut të veçantë për fushën e psikoterapisë në Shqipëri.

Procedura për lëshimin e certifikatës honorifike mund të iniciohet nga anëtarët e SHSHP ose nga publiku, duke i propozuar Bordit Ekzekutiv të SHSHP lëshimin e kësaj certifikate për një profesionist të caktuar. Bordi Ekzekutiv e diskuton propozimin dhe merr vendimin për lëshimin e CSHP honorifike.

Modalitetet e psikoterapisë

Shoqata Shqiptare për Psikoterapi njih të gjitha modalitetet e psikoterapisë, të cilat janë të përfaqësuara në Shoqatën Europiane të Psikoterapisë përmes Shoqatave Europiane Akredituese

për modalitetet përkatëse (EWAO), si dhe ato modalitete që janë të validuara shkencërisht nga Shoqata Europiane e Psikoterapisë.

Përkufizimi i terapisë multimodale

CSHP mund t'i lëshohet psikoterapistëve të cilët praktikojnë modalitetin multimodal të psikoterapisë duke integruar një sërë modalitetesh të njohura psikoterapeutike në praktikën e tyre. Në këtë rast, praktikuesi duhet të plotësojë të gjitha 1400 orët e kërkesave të trajnimit të listuara më lart dhe trajnimi duhet të përmbajë të gjithë elementët e lartpërmendur. Brenda kërkesës minimale të 1400 orëve të CSHP, të paktën 1/3 e trajnimit duhet të jetë në një modalitet të vetëm shkencërisht të vlefshëm, me supervizim, terapi personale dhe praktikë në këtë modalitet. Niveli i trajnimit i fituar në të paktën një modalitet, duhet të arrijë nivelin e avancuar. Aplikuesit do t'i kërkohet të përshkruajë parimet e integritit të modaliteteve të ndryshme në praktikën e vet.

Procedura e aplikimit

Kjo procedurë realizohet nga Komisioni për ÇSHP, i ngritur pranë Shoqatës Shqiptare për Psikoterapi. Dokumentat e aplikimit dorëzohen në original dhe në dy kopje, pranë Komisionit për ÇSHP për vlerësim dhe shqyrtohen brenda një periudhë dy mujorë nga data e dorëzimit të dokumentave. Në rastin e një vlerësimi pozitiv, aplikuesit i lëshohet Certifikata Shqiptare e Psikoterapisë dhe ai/ajo përfshihet në Regjistrin Kombëtar të Psikoterapistëve, i cili mbahet nga SHSHP dhe bëhet publik në faqen e internetit të SHSHP.

Regjistrimi i mbajtësve të CSHP

Individët, të cilëve iu lëshohet ÇSHP, fitojnë automatikisht të drejtën për t'u regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Psikoterapistëve (RKP). RKP njeh praktikën profesionale në psikoterapi. SHSHP është përgjegjëse për regjistrimin e detajeve të praktikuesve të cilët mbajnë CSHP dhe që kanë të drejtën të jenë në RKP.SHSHP e publikon RKP elektronikisht dhe bën të aksesueshme publikisht detajet e të regjistruarve.

Të gjithë praktikuesve të regjistruar ju kërkohet të jenë anëtarë të SHSHP (apo të organizatave anëtare të SHSHP), për sigurimin e cilësisë të Edukimit Profesional në Vazhdim (EPV) dhe të

praktikës etike. Detajet e EPV janë përgjegjësi e SHSHP dhe janë në përputhje me kriteret e EAP për EPV. Tarifa vjetore e anëtarësimit në SHSHP është 3000 lekë të reja.

SHSHP ka një procedurë për heqjen e emrave të praktikuesve nga RKP, për arsye shëndetësore apo etike, për mosplotësimin e kriterëve të EPV, si dhe për mospagimin e tarifës vjetore të anëtarësimit.

Dokumentat e nevojshme për aplikim

1. Dokumentat e nevojshme për aplikimin për të marrë CSHP janë (në origjinal dhe në dy kopje):

- Formulari i plotësuar i CV (gendet në faqen e internetit të SHSHP)
- Formulari i plotësuar i regjistrimit (gendet në faqen e internetit të SHSHP)
- Dy rekomandime, njëri nga një institucion trajnues/trajner për psikoterapi që njih zhvillimin akademik në psikoterapi të aplikuesit dhe njëri nga një psikoterapist, që njih praktikën profesionale të aplikuesit
- Letër motivimi
- Dokumentat që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve për CSHP:
 - Vërtetim nga psikoterapisti personal
 - Vërtetim nga trajnerët në psikoterapi
 - Vërtetim nga supervizori profesional për orët e supervizimit profesional
 - Vërtetim nga supervizori profesional për orët e praktikës nën supervizim profesional
- Kopje të noterizuara të diplomave relevante

2. Për mbajtësit e Certifikatës Europiane të Psikoterapisë, dokumentat e nevojshme për aplikimin për të marrë CSHP janë (në origjinal dhe në dy kopje):

- Formulari i plotësuar i CV (gendet në faqen e internetit të SHSHP)
- Formulari i plotësuar i regjistrimit (gendet në faqen e internetit të SHSHP)
- Kopje të noterizuara të Certifikatës Europiane të Psikoterapisë
- Letër motivimi

Tarifa e aplikimit është 3000 lekë të reja.